



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I LARTË GJYQESOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.2024

VENDIM

Nr.530, datë 25.09.2024

PËR

PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE DHE CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 76 DHE NR. 81, DATË 20.02.2024, PËR KANDIDATEN ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 25.09.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e znj. {...} nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallur me Vendimin nr. 76 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga relatori z. Markelian Koça, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë,

VËREN

I. TË DHËNA MBI KANDIDIMET

1. Me disa vendime të datës 20.02.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin 76 dhe nr. 81, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të JP Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe penale.

2. Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit ishte data 01.03.2024.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr. 76 dhe nr.81 datë 20.02.2024 kandidoi edhe znj. {...} gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

4. Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele, mbështetur në pikën 9, të vendimit 76/81/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 127, datë 11.03.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të

kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj Fatau.

II. TË DHËNA MBI PROCEDURAT

5. Me vendimin nr. 140, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73, , .78.. 83, ..., datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2(dy) vlerësime. II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: 5. Për kandidatin znj. {...} - relator z. Klodian Kurushi;...”.

6. Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidatin znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të kandidimit të tij për lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli, me Vendimin nr. 164, datë 03.04.2024, ka vendosur:

1. Kualifikimin e kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 76 dhe në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Ndërkohë, me Vendim nr.205, datë 17.04.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjat “c” dhe “ë”, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 7, 8 dhe 9 të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 75, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” Këshilli vendosi Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës dhe Tiranë për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 249, datë 24.05.2023; nr. 22, nr. 23 datë 18.01.2023 dhe nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84,85 dhe 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.75 datë 20.02.2024, nr.73, datë 20.02.2024, nr. 83, datë 20.02.2024, nr. 249, datë 24.05.2023, nr. 81, datë 20.02.2024 -relator z. Markelian Koça.

8. Më datë 17.04.2024, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, kandidati u njoftua për vendimit nr. 205, datë 17.04.2024 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për lëvizje paralele, ku ai kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidati nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

III. TË DHËNA MBI KËRKESËN PËR TËRHEQJEN NGA KANDIDIMI

9. Më datë 20.09.2024 kandidati znj. {...}, ka paraqitur kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë nr. 76 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, në fushën e të drejtës penale dhe civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4522 prot., dhe nr. 4521 prot., datë 20.09.2024.

10. Në rrethanat sa sipër, përgatitet ky relacion bazuar në pikën 107, Seksioni “D”, Kreun VI të Vendimit të Këshillit nr.320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” ku përcaktohet se: *“Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele janë të zbatueshme rregullat sipas pikave 54, 55, 59 dhe 60, të këtij vendimi.”*; si dhe në pikën 108 Seksioni “DH” dhe në pikën 109 Seksioni “E”. Gjithashtu është mbajtur në konsideratë si dhe në pikën 59, Seksioni C, Kreun V, të Vendimit nr.320/2020 ku përcaktohet se: *“Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.”*

13. Në Mbledhjen e datës 25.09.2024 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e konsideruar të rregullt procedurën e ndjekur për kandidatin znj. {...} si dhe po ashtu, nëse vlerëson të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidati për t’u tërhequr nga kandidimi për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale dhe civile, të shpallur me Vendimin e Këshilli nr. 76 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, i propozoj që, bazuar në pikën 107, Seksioni D, Kreu VI, të Vendimit nr. 320/2020, të vendosi dërgimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për kandidatin znj. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

IV. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË KANDIDATIT

14. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e lëvizjes paralele të gjyqtarëve, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit për Statusin.

15. Këshilli, në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme, duke u mbështetur në Ligjin për Statusin, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, referuar për këtë në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (më poshtë si Ligji për Qeverisjen). Sipas nenit 43 të Ligjit për Statusin i ndryshuar, procedura administrative për lëvizjen paralele të gjyqtarëve fillon me kërkesën e tyre për shprehje të interesi. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, çka çon në përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat. E drejta e kandidatit për t’u tërhequr nga kandidimi buron nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 64, pika 2, sipas të cilit: *“Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të*

kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka”. Nga ana tjetër, përfundimi i procedurës administrative për shkak të tërheqjes së kërkesës së palës përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, por edhe në nenin 94, pika 1, të këtij Kodi, ku përcaktohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

16. Rregullimet ligjore si më lart janë reflektuar edhe në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Vendimin 320/2020. Kështu, në Kreun IV, Seksioni Ç, pika 29, të tij, përcaktohet se: “Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi në çdo kohë, derisa nuk ka përfunduar procedura e lëvizjes paralele, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim”.

17. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara, konstatohet se kandidati znj. {...}, brenda afatit të kandidimit ka paraqitur kërkesën për tërheqje nga procedura e lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 76 dhe nr. 81, datë 20.02.2024. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së verifikimit të kushteve të tjera ligjore për lëvizjen paralele për këtë pozicion të lirë, ndërsa Këshilli ende nuk kishte marrë një vendim final, kandidati u tërhoq nga kandidimi në këtë procedurë lëvizjeje paralele, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit një kërkesë me shkrim, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin për t’u tërhequr nga kandidimi.

V. KONKLUZIONE

18. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidati znj. {...} të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin për t’u tërhequr nga kandidimi për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë , për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 76 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidatë.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale

dhe civile, të shpallur me vendimin nr. 76 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR